



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2773/6 prot.

Tiranë, më 22.12.2025

VENDIM

Nr. 43, datë 22.12.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, i emisionit investigativ, “Vetting”, në Televizionin “News 24” (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës me nr. 2773 Prot., datë 27.10.2025, saktësuar me e-mail-in datë 29.10.2025, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës për informacion nr. 2510/101 prot., datë 01.10.2025, të depozituar në adresat elektronike Alketa.Rreli@fsdksh.gov.al dhe info@fsdksh.gov.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1.a) Listën e plotë të barnave të rimbursueshme për periudhën nga 1 janari 2020 – 30 shtator 2025, ku institucioni juaj i rimbursion nëpërmjet skemës së rimbursimit dhe qendrës së shpërndarjes, me vendodhje në farmacinë e QSUT-së. Ju lutem, ti specifikoni sipas çdo viti.

1.b) Cila është vlera vjetore e rimbursimit për këtë kategori barnash për periudhën kohore 1 janar 2020 – 30 shtator 2025?

2) Cilat janë kompanitë që ka lidhur kontratë institucioni i FSDKSH-së për këtë kategori barnash (barna të rimbursueshme) për periudhën kohore 1 janar 2020 – 30 shtator 2025? Ju lutemi ti specifikoni sipas çdo viti.

3) Në çfarë mase të shprehur në vlerë monetare është realizuar skema e rimbursimit për secilën kompani, me të cilën është lidhur kontrata me FSDKSH-në për periudhën kohore 1 janar 2020 – 30 shtator 2025? Ju lutemi, ti specifikoni sipas çdo viti.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji, konkretisht, urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 01.10.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2773/1 prot., datë 30.10.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesat për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 5733/1 prot., datë 07.11.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2773/2 prot., datë 10.11.2025, i ka kthyer përgjigje Ankuesit.

Ankuesi ka vijuar ankimin e tij nëpërmjet e-mail-it të datës 10.11.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2773/3 prot., datë 10.11.2025, e-mail-in datë 21.11.2025, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2773/4 prot., datë 25.11.2025 dhe e-mail-in datë 02.12.2025, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2773/5 prot., duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të objektit të ankimit si dhe konsultimit të legjislationit përkatës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislationin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Konstatohet se Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimet sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.*

Vlen të theksohet se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, i referohet kontratave të lidhura nga Autoriteti Publik, si dhe pagesa të kryera në zbatim të këtyre kontratave, të cilat në bazë të ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011 *“Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, i cili në nenin 23 të tij parashikon se: *“Fondi ka burimet e financimit si më poshtë: a) kontributet e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, sipas pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji; b) kontributin e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor prej buxhetit të shtetit nga personat ekonomikisht joaktivë, sipas pikës 2 të nenit 5 të këtij ligji; c) kontributet e sigurimit shëndetësor vullnetar, sipas pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji; ç) transfertat nga Ministria e Shëndetësisë për subvencionimin e një pjese të pagesave të drejtpërdrejta, sipas pikës 2 të nenit 11 të këtij ligji; d) transfertat nga Ministria e Shëndetësisë për shërbimet e kërkuara nga ajo, përtej atyre të buxhetuara ose të kontraktuara nga fondi; dh) transfertat e miratuara në buxhetin e shtetit për balancimin e buxhetit të Fondit ose për kompensimin e mosrealizimit të kontributeve në procesin e zbatimit të buxhetit. e) burime të tjera, dhurime, grante nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare.”*, financohen plotësisht nga buxheti i shtetit dhe kontributet e sigurimit shëndetësor të qytetarëve. Rrjedhimisht duke qënë se kanë lidhje të ngushtë me sistemin shëndetësor dhe sistemin e kontributeve, të cilët prekin drejtpërsëdrejti qytetarët, interesi publik për të aksesuar informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe tejet i lartë.

Autoriteti Publik, në kthim përgjigjen e drejtuar ankuesit, jo vetëm që nuk është bazuar në parashikimet e ligjit specifik, nr. 10 383, datë 24.02.2011 *“Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar por as në parashikimet e nenit 17 të LDI, për mosdhënien e informacionit/dokumentacionit.

Nga hetimi administrativ i kryer nga Zyra e Komisionerit rezulton se në legjislacionin specifik të Autoritetit Publik nuk ka asnjë pengesë ligjore për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Ndërkohë, në lidhje me pikat 1.a dhe 1.b të kërkesës për informacion, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin pasi ka vendosur në dispozicion të ankuesit linkun e saktë ku ndodhet informacioni/dokumentacioni i kërkuar në bazë të kërkesës së datës 01.10.2025. Në këto kushte, duke qenë se Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion dokumentacionin, detyrimi për informim konsiderohet i përmbushur. Rrjedhimisht, Komisioneri vlerëson se ky kërkim duhet rrëzuar.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e *“mbikëqyrësit shoqëror”*, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012

“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së , z. , i emisionit investigativ, “Vetting”, në Televizionin “News 24”, nr. 2773 prot., datë 25.10.2025, ndaj Autoritetit Publik, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 01.10.2025, për pikën 2 dhe 3, konkretisht: “2) Cilat janë kompanitë që ka lidhur kontratë institucioni i FSDKSH-së për këtë kategori barnash (barna të rimbursueshme) për periudhën kohore 1 janar 2020 – 30 shtator 2025? Ju lutemi ti specifikoni sipas çdo viti. 3) Në çfarë mase të shprehur në vlerë monetare është realizuar skema e rimbursimit për secilën kompani, me të cilën është lidhur kontrata me FSDKSH-në për periudhën kohore 1 janar 2020 – 30 shtator 2025? Ju lutemi, ti specifikoni sipas çdo viti. ”, brenda datës 30.12.2025.
3. Rrëzimin e ankesës për pikat 1.a dhe 1.b të kërkesës për informacion datë 01.10.2025, konkretisht: “1.a) Listën e plotë të barnave të rimbursueshme për periudhën nga 1 janari 2020 – 30 shtator 2025, ku institucioni juaj i rimbursion nëpërmjet skemës së rimbursimit dhe qendrës së shpërndarjes, me vendodhje në farmacinë e QSUT-së. Ju lutem, ti specifikoni sipas çdo viti. 1.b) Cila është vlera vjetore e rimbursimit për këtë kategori barnash për periudhën kohore 1 janar 2020 – 30 shtator 2025?”.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 22.12.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi